



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2351/ Prot.

Tiranë, më 3.7. 2020

URDHËR

Nr. 212, Datë 3.7.2020

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË  
“BACHELOR” NË “EKONOMIKS DHE FINANCË” ME PROFILE “EKONOMIKS”,  
“FINANCË” DHE “KONTABILITET” NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT,  
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profil në “Marketing”, “Menaxhim”, “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, me kohëzgjatje normale 4 vite akademike (8 semestra), në “Bachelor”, në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet” me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.

Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor”, në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabilitet”, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, sipas raportit të vlerësimit, bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.
4. Universiteti i New York-ut, Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i New York-ut, Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshitasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut, Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Besa SHAHINI**



Bazuar në sa më sipër, konkludojmë se programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks dhe Financë” me profile “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Kontabiliteti” parqitur nga UNY Tiranë” plotëson kriteret për ta konsideruar pozitivisht si riorganizim të tij, por nevojiten të merren në konsideratë komentet dhe sugjerimet tona të cilat plotësojnë vlerësimin e ekspertëve për kërkesat e nevojshme të cilat do të rrisin më tej cilësinë e këtij programi.

**Sugjerime dhe rekomandime:**

1. Programi në profilin “Finance” dhe deri diku edhe në profilin “Kontabilitet” mund **“të çlirohet”** nga lëndë që janë të karakterit teoriko-shkencor dhe që mund të zhvillohen në ciklet e dyta të programeve mësimore. Kështu lënda “Derivatet dhe Instrumentet Financiare”, lënda “Vendimmarrja Strategjike” apo deri diku edhe lënda “Metodat e Kërkimit ne Shkencat e Aplikuarat” mund të zëvendësohen me lëndë të fushës kryesore me teknike dhe profesionale që do u shërbejë në tregun e punësimit. Nga ana tjetër, duke parë përmbajtjen e lëndëve mungon marrja e njohurive bazë të kontabilitetit dhe të financës në lëndët respektive “Kontabiliteti Financiar” dhe “Drejtimi Financiar”. Këto njohuri mund të merren në lëndë të mirëfillta si “Bazat e Kontabilitetit” dhe “Bazat e Financës” që do të trajtohenin në kursin e I-re. Një hapësirë për të përfshirë këto lëndë bazë mund të ishte zhvillimi i lëndës “Shkrim Akademik” ne një semestër nga dy semestra e vendosur në planin mësimor.
2. Në programin me profil “Ekonomiks” mund të përfshihet lënda “Financa Publike” si një lëndë me karakter makroekonomik dhe formuese për këtë profil.
3. Ne mënyrë që njohuritë e marra nga studentët gjatë tre viteve të merren në vijimësinë e tyre logjike mund të bëhen disa “spositime” në semestrat përkatëse. Kështu, lënda “Kontabilitet Kosto” duhet te zhvillohet me përpara se lënda “Kontabilitet Drejtimi” ne profilin e kontabilitetit. Po kështu do ishte me përfaqësuse nëse lënda “Etika në Kontabilitet” që është me zgjedhje të ndërronte vend me lëndën “Etika ne Biznes” që është e detyrueshme në këtë profil.